



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 31.5.2022, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vijimi i raportimit të veprimtarisë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021 dhe kthimi i përgjigjeve të drejtuara në mbledhjen e mëparshme.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Erion Braçe, Alban Xhelili, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Edmond Spaho dhe Pranvera Resulaj.

Mungojnë:

Alfred Rushaj, Agron Shehaj, Bujar Leskaj, Benet Beci, Vullnet Sinaj dhe Jorida Tabaku.

Të ftuar:

Arben Shehu – Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Marjola Llanaj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Valbona Gaxha – Sekretare e Përgjithshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Gjovalin Preçi – Drejtor i Departamentit të Buxhetit në Kontrollin e Lartë të Shtetit

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Kuorumi është i plotë, ndaj mbledhjen e deklaroj të hapur.

Në rendin e ditës së sotme kemi vijimin e raportimit të veprimtarisë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021 dhe është pikërisht dita kur do të kthehen përgjigjet për pyetjet e bëra. Relatore kemi zonjën Enslemvera Zake dhe zonjën Emilja Koliqi.

Para se të fillojmë mbledhjen, ka kërkuar fjalën për procedurë zoti Spaho.

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Zoti kryetar, më vjen keq ta them, por mbledhja duhej të fillonte me një ndjesë, në radhë të parë, ndaj Kontrollit të Shtetit dhe kryetarit të saj dhe, në radhë të dytë, ndaj nesh. Ka një mungesë të thekuar të organizimit. Unë e kuptoj që ju mund të jeni angazhuar edhe në detyra të tjera, por kjo nuk ju pengon fare që të autorizohet dikush tjetër për të filluar mbledhjen dhe po bëhet e disata herë që ne fillojmë me shumë vonesë. Pra, shtyhet mbledhja, njerëzit nuk mbledhen. Nuk ka ndodhur kurrë që të vijë një institucion, aq më tepër një institucion kaq i rëndësishëm, para nesh, pret dhe më pas shtyhet mbledhja. Mendoj se ka nevojë për reflektim.

Eduard Shalsi – E para, me kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë qenë në vijimësi në kontakt zoti Spaho, duke i shpjeguar rrethanat.

E dyta, këtë mbledhje mund ta kryesojnë edhe nënkryetarët, por nuk ishte kuorumi, sepse më duhet shumë herë t’ju pres...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, në qoftë se ke marrë përsipër të ndezësh mikrofonin për të thënë një diçka dhe të mos dëgjosh asnjë gjë, ma thuaj që në fillim që të mos merrem fare dhe ta mbyllim këtë histori. Kuorumin nuk e bëj unë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kuorumin e bëni ju që më duhet t’ju pres vazhdimisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur secili prej jush të bëhet i përgjegjshëm, se nuk jam unë xhandar për të mbajtur rendin edhe kur vijnë njerëzit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më vjen keq që po e hap këtë debat dhe po e bën këtë debat tani, por mos e transmeto këtë frymë, mbaje për atje te foltorja atë frymë.

Edmond Spaho – Kjo është mungesë respekti ndaj institucioneve.

Eduard Shalsi – Të lutem, le të flasë kushdo për mungesë respekti për institucionet, por vetëm ju të mos flisni, se e keni bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos na e përcill foltoren këtu, mbaje atje ku e ke, ruaje pak etikën.

Të ftuar kemi kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotin Arben Shehu, zonjën Marjola Llanaj, drejtoreshë e Përgjithshme; zonjën Valbona Gaxha, sekretare e Përgjithshme dhe zotin Gjovalin Preçi, drejtor i Departamentit të Buxhetit.

Mirë se erdhët në komision!

Atëherë, po ju jap fjalën, pyetjet janë të zbardhura, të transmetuara. A ka ndonjë gjë që doni të thoni paraprakisht lidhur me pyetjet?

Arben Shehu – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, anëtarë të komisionit!

Sipas njoftimit, mbas vendimmarrjes suaj, jemi prezentë për të vazhduar seancën e raportimit të veprimtarisë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021. Ashtu siç u vendos nga ana juaj në komision, për shkak të numrit të madh të pyetjeve të drejtuara nga anëtarët i jemi përgjigjur Komisionit për Ekonominë dhe Financat në mënyrë të detajuar për secilën nga pyetjet me shkrim, megjithatë ne jemi prezentë, do të jemi prezentë dhe do të jemi të gatshëm që të përgjigjemi, mbase edhe për plotësim të tjera që mund t'i vlerësoni të nevojshme apo për pyetje të reja nëse do të ketë nga ana e anëtarëve të komisionit. Përgjigjet janë të drejtuara me shkrim për secilën nga pyetjet dhe të drejtuar për secilin nga anëtarët e komisionit që i ka drejtuar këto pyetje. Janë të detajuara dhe mendoj se janë të plota si përgjigje.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Relatorët, zonja Zake apo zonja Koliqi, ndonjë koment?

Po, zonja Koliqi.

Emilja Koliqi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit të gjithë përfaqësuesve të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit!

Unë i vlerësoj përgjigjet që ju keni dhënë për të gjitha pyetjet, sipas secilit prej anëtarëve të komisionit. Dua të theksoj vetëm një pyetje që unë e kisha në lidhje me ndjekjen e kallëzimeve

penale. Në fakt, nga ana juaj është dhënë një përgjigje, por nuk e shikoj shtruese, në një kohë që për shumë vjet ju keni rreth 300 kallëzime penale, por unë dua të di: cili është dënimi përfundimtar për këta personave që ju keni dërguar? Pra, a është finalizuar me një vendimmarrje konkrete si nga ana e gjyqësorit, por edhe nga ana e prokurorisë? Përveç kallëzimeve penale, ju keni dhënë edhe masa të tjera rekomandime, por unë dua të them: sa efektive janë dhe sa ia kanë arritur qëllimit këto masa e rekomandime që ju keni paraqitur? Sa janë dënuar ata që kanë krijuar dëme ekonomike, për më tepër edhe vepra penale në kurriz të taksapaguesve shqiptarë? Dëmi ekonomik 19 miliardë lekë, që ju keni paraqitur në këtë raport, është goxha i konsiderueshëm, por, përveç kësaj, janë edhe borxhi tatimor e doganor, ku borxhi tatimor arrin në 122 miliardë lekë, borxhi doganor në 45 miliardë lekë. Këto janë shifra të konsiderueshme, të cilat vënë para përgjegjësisë të gjithë administratën tatimore dhe doganore në Republikën e Shqipërisë. Dua të theksoj se, në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme, siç del edhe nga raporti juaj, por edhe, me sa kam vë re unë në momentin kur është paraqitur në Komisionin e Ekonomisë dhe në parlament realizimi i buxhetit të vitit 2020, mungojnë pasqyrat financiare të konsoliduar, gjë që është vënë në dukje nga ana juaj dhe, përveçse është vënë në dukje mungesa e raportimit të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, është vënë në dukje edhe mospasqyrimi i saktë i gjendjes reale financiare të qeverisjes së përgjithshme.

Një gjë tjetër, që unë dua të vë në dukje dhe që më duket me rëndësi shumë të madhe, sidomos në lidhje me efektivitetin e menaxhimit të situatës COVID-19 nga ana juaj, janë një sërë gjetjesh, përveç kësaj janë edhe të tjerat në lidhje me pasojat e tërmetit, ku më kryesorja nuk ka një plan të miratuar të menaxhimit të pasojave pas tërmetit. Pra, për mua janë gjetje mjaft të rëndësishme, të cilat duhet të na vënë përpara një pune të madhe që duhet të kryhet nga ana e qeverisjes së përgjithshme për t'i rregulluar ose për t'i sistemuar të gjitha këto rekomandime, gjetje, por edhe për të marrë masat e duhura që ato të përmirësohen në të ardhmen.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, fjala për ju.

Arben Shehu – Faleminderit, zonja deputete!

Në lidhje me pyetjen për kallëzimet penale, dua të parashtoj edhe një herë se detyrë e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në rastet e konkludimit të konstatimit të shkeljes së ligjit penal, pra të konstatimeve të kryerjes së veprave penale mbi bazën e provave të plota dhe jo

të dyshimeve, është të drejtohet me kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme apo prokuroritë e rretheve gjyqësore.

Në lidhje me ecurinë e proceseve, thjesht dua t'ju vë në vëmendje, mbase për shkak të rëndësisë dhe të kompleksitetit të rasteve që ne kemi parashtruar me kallëzimet penale, sidomos në prokurorisë speciale, dua t'ju kujtoj se nevojitet një kohë e plotë për të arritur edhe nga ana e organit të prokurorisë konkludimet e rasteve konkrete. Jam i bindur se të gjitha ato raste, që ne kemi parashtruar në radhë të parë, janë të bazuara në prova konkrete, siç thashë, dhe jo në dyshime, e para, dhe e dyta, kam besimin e plotë se prokuroria po kryen në mënyrë shteruese të gjitha veprimet, për të cilat ligji e detyron që të kryejë. Jam i bindur se rezultatet në vijimësi do të jenë konkrete, do të jenë të plota, pra reale.

Dua të garantoj edhe një herë se të gjitha këto veprime, siç e thashë, e përsëris të pasqyruara me kallëzime penale, janë të mbështetura në prova të plota dhe jo në dyshime. Jam i bindur që rezultatet do të jenë në vazhdimësi, jo vetëm për rastet që kemi parashtruar por edhe në ato për të cilat jemi të detyruar t'i drejtojmë në prokurori me kallëzime penale do të jenë rezultative dhe do të jenë frytdhënëse për të gjitha institucionet dhe në tërësi për të gjithë shoqërinë shqiptare, e cila ka nevojë që institucionet të jenë konkrete, të jenë të gjitha rezultative dhe frytdhënëse mbi bazën e një pune të koordinuar, e cila mendoj se sot momentalisht është e plotë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, zonja Koliqi.

Në rregull!

Koleg tjetër? Po, zonja Zake.

Arben Shehu – Edhe një diçka tjetër, zoti kryetar, siç parashtrova fillimisht, në lidhje me pyetja të tjera apo plotësimet, nëse ju i vlerësoni se duhet të adresojnë pyetje të veçanta për të dhënë sqarime të tjera, jemi të gatshëm në çdo moment që ju ta vlerësoni për t'i plotësuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve të reja, të cilat mund të vlerësohen të nevojshme nga ana juaj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Zake.

Enslmvera Zake – Faleminderit, kryetar!

Patjetër, ashtu si edhe kolegja Koliqi, ne e vesojmë të gjithë seriozitetin e përgjigjeve të pyetjeve që Kontrolli i Lartë i Shteti na ka vënë në dispozicion. Do ta mbështes kolegen Koliqi në lidhje me databazën e kallëzimeve penale apo edhe observacioneve, për të cilat jeni përgjigjur se

nuk keni të dhëna të sakta lidhur me numrin e observacioneve të pranuar, jo të pranuar dhe si janë klasifikuar këto apo edhe se në çfarë procesi janë kallëzimet penale. Pra, kam një sugjerim që në të ardhmen të keni një databazë statistikore që na informon dhe na jep një informacion më të hollësishëm jo vetëm për mirëfunksionimin të institucioneve, për të cilat ju jepni rekomandime apo i ndiqni penalisht, por edhe për performancën e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Patjetër që Kuvendi është i gatshëm dhe ne, si anëtarë të Komisionit të Ekonomisë, e kemi përgjegjësinë për t'i dëgjuar raportet vjetore të institucioneve të pavarura dhe jemi të gatshëm t'ju mbështesim me të gjitha elementet e nevojshme që ju do të keni nevojë, qoftë edhe për ndryshimet ligjore apo edhe mbështetje të formave që ju do t'i vlerësoni.

Gjithashtu, edhe një pyetje tjetër, e cila ishte dhënë edhe në përgjigjet e pyetjeve (nëse raportet publikohen ose jo vendoset nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit), a keni ju një model apo një raport se si vlerësoni se cilat raporte do të publikohen, apo jo? Përgjigjet ishin shteruese, kështu që nuk është se kam ndonjë pyetje tjetër, në qoftë se kolegët e tjerë kanë...

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, patjetër.

Arben Shehu – Faleminderit!

Edhe një herë në lidhje me pyetjen për kallëzimet penale, unë jam i bindur se ne i kemi dhënë rëndësinë e duhur përgatitjes së kallëzimeve penale në ato raste kur vlerësohet se kemi të bëjmë me vepra penale. Unë mendoj se për të gjitha institucionet, për të gjithë shtetin, për më tepër për të gjithë shoqërinë shqiptare, më i rëndësishëm se konstatimi real i veprave penale, i shkeljes së ligjit penal, është parandalimi i kryerjes së veprave penale. Unë vlerësoj se puna e të gjitha institucioneve duhet të fokusohet në mënyrë mbase edhe të koordinuar për ndërgjegjësimin e të gjitha stafeve e të gjithë punonjësve për të rritur punën parandaluese, që, së pari, të shmangen pasojat për dëmet që mund të shkaktohen në buxhetin e shtetit, njëkohësisht edhe dëmet që mund të shkaktohen për pasojë të natyrave të ndryshme që sjellin procedimet penale për këta individë, për familjet e tyre apo për të gjithë shoqërinë. Për më tepër, duhet të fokusohemi në parandalim, sepse mendoj se është e rëndësishme të ndërpritet ose, në variantin më të mirë, të parandalohet kryerja e veprave penale sesa të bëhet administrimi ose përlllogaritja e dëmeve, të cilat, në fund të fundit, janë detyrime që i paguan çdo shtetas shqiptar, pasi është një proces i gjatë, është kosto e shtuar për të gjithë, qoftë në planin financiar, edhe në planin shoqëror, që mendoj se është po aq i rëndësishëm sa edhe dëmi në financat e shtetit. Pra, të dyja këto janë pasoja që do t'i vuajnë

qytetarët shqiptarë. Mendoj se puna kryesore e të gjitha institucioneve, për të gjithë ne, do të ishte kordinimi për të rritur nivelin e parandalimit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Për publikimet?

Arben Shehu – Për publikimet mendoj se kemi pasur transparencë të një niveli të plotë, duke vënë çdo akt në dispozicion të çdo qytetari që ka qenë dhe është i interesuar, dhe për mediet e ndryshme, të cilat po kryejnë një rol të jashtëzakonshëm në rritjen e punës evidentuese të situatave të ndryshme. Mendoj se kjo situatë është në nivelin e duhur.

Eduard Shalsi – Pyetja e zonjës Zake, në mos gaboj, kishte të bënte me faktin që jo të gjitha publikohen.

Çfarë procesi ndjek përzgjedhja?

Kjo ishte pyetja e zonjës Zake.

Arben Shehu – Mendoj se publikimi është i plotë në vazhdimësi. Siç u shpreha, jemi rast pas rasti, në kohën më të shpejtë të mundshme, të gatshëm t'i vendosim në dispozicion çdo akt çdo qytetari të republikës që është i interesuar.

Eduard Shalsi – Po, zonja Denaj.

Anila Denaj – Faleminderit, kryetar!

Kam një koment për atë që tha kryetari i institucionit, që parandalimi është më mirë se ndjekja e dëmit. Në këtë funksion do të ishte shumë e udhës që pjesa e ndërgjegjësimit të ishte me instrumente konkrete, ku një nga ato që unë do të shikoja me përfitueshmëri institucionale, do të ishte që plani i auditimit të çdo institucioni, që bazohet në risqet që ka çdo institucion, të harmonizohet me raportimet që kanë dalë në 2-3 vjetët e fundit, si në raport me dëmet e shkaktuara nga raportimi i 1 viti më parë, por edhe nga mosndjekja e rekomandimeve dhe të dyja së bashku të krijojnë një harmonizim komunikimi më institucional në kuadër të ndërgjegjësimit. Pra, pavarësisht se nuk janë në funksion të mbikëqyrjes apo vëmendjes suaj juridike, të paktën të ketë një komunikim 1 herë në vit, që këto plane auditimi institucionale, para se të aprovohen nga titullarët, të marrin parasysh edhe gjetjet e mëparshme nga institucioni juaj përgjegjës. Kjo të krijojë bazën, ku edhe risku individual i institucionit, edhe risku i matur prej jush në 2-3 vjet, jo i 1 viti, se 1 vit është shumë pak, të kenë mundësi për një komunikim, jo obligues, por të paktën ndërgjegjësues, për të thënë: këto janë problematikat më të shpeshta të ndodhura, si në raportet me gjetjet dhe me mosndjekjen e rekomandimeve, dhe këto sugjerime do të ishte mirë të vendoseshin

në matricën e planit të veprimit të audituesve të brendshëm në funksion të titullarëve për të firmosur më vonë, sepse shpesh institucionet krijojnë këto ndjekje, sipas problematikave të tyre, por duhet parë si një fushë veprimi më e gjerë se sa e një institucioni.

Faleminderit!

Arben Shehu – Unë u shpreha se kemi bindjen që parandalimi, nëse është shprehja e duhur, është më i shëndetshëm për shoqërinë shqiptare se ndëshkimi. Mendoj se duhet të vijmë në një lloj tempri në ulje ndëshkimi në vazhdimësi. Me këtë nuk dua të them se ne do të heqim dorë, do të ulim detyrimin apo do të ndikojmë në detyrimin që kemi për të pasuruar me kallëzime konstatimet e veprave penale, por mendoj se parandalimi është i rëndësishëm për argumentet që trajtova.

Megjithatë, për sa i përket qëndrimit të zonjës deputete, ne, para se të përcaktojmë planin vjetor të auditimeve, bëjmë një analizë për rastet kur kemi auditime të shtuara në bazë të kërkesave apo të konstatimeve të veçanta përgjatë punës së vitit auditues, po ashtu bëhet edhe një analizë për rastet që kanë ndjeshmëri më të lartë, kanë risk dhe interes më të lartë nga shoqëria dhe institucionet.

Dua të theksoj sërish se puna parandaluese nuk mund të bëhet vetëm nga një institucion, pavarësisht se sa i rëndësishëm mund të jetë, siç është rasti i institucionit, pjesë e të cilit jemi edhe ne, por mendoj se duhet të jetë një punë e koordinuar e të gjitha institucioneve, që parandalimi të jetë efikas, të mos ngelet vetëm në kuadrin e diskutimeve apo të qëndrimeve të një individi apo të një përfaqësuesi të një institucioni apo anëtari, pjesëtar i institucionit, dhe për më tepër në këto raste, në këto momente. Pra, duhet të jetë efikas, sepse është i rëndësishëm për të gjithë ne, nuk është i rëndësishëm vetëm për qytetarët shqiptarë, por edhe për ne, sepse jemi pjesë e kësaj shoqërie. Pra, të gjithë ne duhet të jemi të interesuar, të luajmë rolin për të cilin jemi të ngarkuar për ta kryer, për ta luajtur pra; koordinimi duhet të jetë i domosdoshëm, në të kundërt nuk besoj se do të funksionojë në atë nivel që kuptohet që është i nevojshëm parandalimi.

Faleminderit!

Anila Denaj – Jemi duke thënë të njëjtën gjë, por për të vendosur një instrument koordinimi, duhet që planet e auditimit, jo tuajit si institucion, por të institucioneve të harmonizohen në kontekst risku me eksperiencën e 2-3 vjetëve të fundit të raportimeve tuaja, në mënyrë që ekzaktësisht të kemi një benefit maksimal për shoqërinë dhe jo të ketë një institucion një matricë risku, që mund të jetë e saktë, por e paharmonizuar edhe me matricën e madhe të riskut

të të gjitha institucioneve që përcaktoni ju. Pra, sikur një tryezë rrumbullake një herë në vit me drejtuesit që kanë përgjegjësi për të përcaktuar se cili do të jetë plani i auditimit të iks institucioni, të jetë absolutisht edhe në vëmendje të të gjithë matricës së riskut që ju keni harmonizuar. Pra, po flas për harmonizim ndërinstytucional. Kjo nuk është me forcë ligjore, por është me forcë ndërgjegjësimit, me atë që ju thatë pak më parë: sikur një herë në vit të ulet pjesa e audituesve të nivelit më të lartë të iks institucioneve me një përfaqësues tuajin dhe të diskutojnë, jo me detyrim, mendoj se është një instrument i parë ndërgjegjësimit. Megjithatë, ky është një kënd. Nuk mund të them se është i vetmi, por është shumë e saktë ajo që thoni ju. Ne duhet të komunikojmë më shumë për të përcaktuar që të parandalojmë, duke vendosur më tepër theksin aty ku ka më tepër risk, por që në fund të kemi edhe një benefit të përbashkët të eficiencës mes të gjitha institucioneve, jo një institucion të shkojë dhe të bëjë një auditim të shpeshtë të një subjekt institucional të tij, ndërkohë që risku është diku tjetër. Pra, një vëzhgim më i harmonizuar. Kjo kërkon bashkëpunim të të gjitha institucioneve dhe vullnet, mbi të gjitha, por si një hap i parë, mendoj se vlen të ketë një iniciativë të tillë, por është për t'u parë, sepse mund të ketë nevojë për komunikime të ndryshme.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zonja Dhima.

Më pas do të flasë zonja Gjylameti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Emilja Koliqi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të fjalës së zonjës Denaj, unë do të thosha se do të ishte i mirë bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, me Drejtorinë e Përgjithshme të Kontrollit të Menaxhimit Financiar, ku është edhe Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Kjo mund të bëjë edhe këtë lidhje dhe këtë kombinim të të gjitha planeve të auditeve dhe planeve të veprimit vjetor me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Faleminderit!

Arben Shehu – Ideja është që çdo institucion duhet të ketë një lloj autokontrolli. Kjo është e domosdoshme në momentet që po jetojmë, për t'i paraprirë apo për të ndërtuar një themel të parandalimit, sepse, sado që puna jonë apo puna matej, shumë e rëndësishme e prokurorisë, të jetë në nivelin e duhur, që unë mendoj se absolutisht është në nivelin e duhur, nuk do ta plotësojë kurrë

atë që do të plotësojë kjo nevojë për koordinim që unë theksova, në mënyrë që situatat të analizohen rast pas rasti dhe të veprohet në kohën e duhur për të kryer këto veprime parandaluese.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

E falënderoj kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për përgjigjet shteruese që na ka dhënë për pyetjet që ne kemi bërë në raportin e veprimtarisë së atij institucioni për vitin 2021!

Një nga pyetjet që unë kam bërë është referuar numrit të madh të rekomandimeve që ju keni dhënë në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Në përgjigje theksohej se gjatë vitit 2021 janë ushtruar 55 auditime për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për vitin 2020. Në këto rekomandime janë 62 subjekte, nga të cilat ka rezultuar se janë dhënë 1376 rekomandime për përmirësime ligjore, për masa organizative, për masa administrative, masa disiplinore dhe nga të cilat janë pranuar 1292 ose 93% të masave të rekomanduara nga ana e institucionit tuaj.

Njëkohësisht, nuk janë pranuar 84 masa, 6% e atyre të rekomanduara nga ana juaj.

Si do të veprohet nga institucioni juaj për këto masa? A ka një bazë ligjore që janë konstatuar dhe janë marrë këto masa nga institucioni juaj? A janë argumentuar nga ana e institucioneve kontrolluese pse nuk zbatohen këto masa?

E dyta, për largimet nga puna në institucionin tuaj, në përgjigjen e pyetjes theksohet se ka pasur 2 raste të largimit nga shërbimi civil për shkaqe disiplinore, 8 raste të lirimt nga detyra, të cilat janë ndjekur nga ana juaj, dhe 5 raste mendohet ose theksohet në material, që janë fituar ose kanë lënë në fuqi vendimin e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. A ka përfunduar gjykimi i këtyre në të gjitha shkallët e gjyqimit? A ka një vendimmarrje që lë në fuqi vendimin e institucionit tuaj për largimin nga puna të këtyre 8 rasteve?

Faleminderit!

Marjola Llanaj – Përshëndetje!

Për sa i përket pyetjes për rekomandimet, besoj se pyetja është për 6% të rekomandimeve që nuk janë pranuar nga institucionet.

Për ne është më se normale që ka edhe rekomandime që nuk mund të pranohen nga të gjitha institucionet, por hapat që ne ndjekim për analizën e këtij 6%-shi, se pse nuk janë pranuar, fillojnë nga pjesa e brendshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Domethënë, nëse është analizuar qartësisht nga audituesit tanë dhe a është rekomandimi në përputhje me gjetjen? Vlerësimi bëhet një herë

brenda nesh dhe më pas shikohet edhe arsyetimi që bën institucioni. Ndërkohë, gjatë zbatimit të rekomandimeve në shkojmë në institucion, i diskutojmë me titullarët e institucionit apo me strukturat që kanë për detyrë ose kanë refuzuar zbatimin rekomandimit, dhe ndiqet në vijimësi, në dinamikë, për të gjetur arsyetimet, ato që kanë bazë dhe me të drejtë institucionet nuk i pranojnë, pa diskutim që reflektohet nga ana jonë dhe ndërkohë, ato që ne gjykojmë se janë të rëndësishme dhe nuk zbatohen nga ata, ne rikërkojmë deri në fund zbatimin e tyre dhe i përfshijmë në raportet që nisim në Kuvend me insistimin që ata të vijnë ta zbatojnë këtë rekomandim. Domethënë, ne e kemi procedurë pune, që bëjmë një analizë të detajuar të arsyeve pse këto refuzohen apo nuk zbatohen nga institucioni. Megjithatë, pasqyra që ju kemi dhënë flet se përgjithësisht institucionet kanë një përqindje të lartë të pranimit të rekomandimeve dhe përgjithësisht është pozitive qasja e masave organizative që ndihmojnë në zhvillimin e këtyre institucioneve, në plotësimin dhe rregullimin e brendshëm institucional të tyre për të vijuar me punën e tyre të përditshme, ndërkohë që 6%-shi mund të jetë dëm ekonomik, që nuk e pranon, ose nuk përbën në thelb, pavarësisht se ne e marrim në analizë dhe gjithmonë kemi një të detajuar.

Antoneta Dhima – Në praktikën e institucionit tuaj është që ju u dërgoni institucioneve një raport paraprak për gjetjet dhe institucionet, për aktet e verifikimit dhe njëkohësisht për procesverbalet, bëjnë një observacion për gjetjet që ju keni bërë dhe paraqesin edhe dokumente justifikuese për problematikat që duhet të merren parasysh nga ana juaj. Mendoj se masat administrative organizative disiplinore janë masa përfundimtare që bëhen nga institucioni juaj, pasi ju ose grupi i punës, që ka qenë për auditim në institucion, keni konkluduar për këto masa. Nuk mundet që këtë 6-përqindësh, që ju thoni se mblidheni, e diskutoni, ta quani të mirëqenë, sepse kjo tregon se stafi, i cili ka shkuar atje për auditim, nuk ka bërë detyrën që duhet, apo jo?

Arben Shehu – Duke iu referuar përgjigjeve tona, ju u shprehët se ka një shifër të konvertuar në 6% të rekomandimeve të pazbatuara, por nuk do të thotë që, meqë këto nuk janë zbatuar nga institucionet apo subjekteve, për të cilat ne kemi kryer auditimin, nuk është zbatuar dhe kjo është në përgjegjësinë e KLSH-së. Absolutisht jo. Ne kemi kryer të gjitha veprimet dhe konkluzionet në të cilat jemi drejtuar me këto rekomandime, jemi të bindur se kanë qenë të domosdoshme, jo të nevojshme, por kjo nuk do të thotë se është një mangësi nga ana jonë. Moszbatimi i tyre nuk është mangësi nga ana jonë.

Për më tepër, ne në këto raste e kemi të detyrueshme të bëjmë një analizë të dytë, sepse paraprakisht bëhet analizë e thelluar nëse duhet të drejtohem me rekomandimin përkatës, apo jo,

por në rastet e moszbatimit përsëri e kemi të domosdoshme të kryejmë një analizë të thelluar të dytë për të parë edhe një herë situatën në të cilën ndodhemi. Siç u përgjigjëm, ne u drejtohem përsëri subjekteve të audituara, duke insistuar në zbatimin e këtyre rekomandimeve. Mendoj se është për t'u vlerësuar shifra e lartë e zbatimit nga ana e institucioneve.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, e ka kërkuar fjalën zoti Xhelili, ka një koment zonja Resulaj dhe e mbyll zonja Gjylameti.

Alban Xhelili – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj kryetarin e KLSH-së, si dhe përfaqësuesit e saj!

Unë kisha një koment lidhur me pyetjet që i kam adresuar KLSH-së. Qëllimi i këtyre pyetjeve ka qenë për të parë cilësinë e auditivit. Të them të drejtën, në vlerësimi im, duke parë përgjigjet e pyetjeve, nuk lidhet thjesht me cilësinë e auditimit që, pas atyre përgjigjeve do ta klasifikoj shumë cilësor, por edhe në aspektin sasior, por dhe seriozitetin në dhënien e përgjigjeve.

Gjithashtu, kam një koment lidhur me perceptimin që krijohet rëndom, ku KLSH-ja trajtohet edhe si institucion ekzekutiv. KLSH-ja nuk është një institucion ekzekutiv, por konstatues. Duke marrë shkas nga kjo, si dhe duke marrë në konsideratë atë që sapa tha kryetari, nuk mund të jetë përgjegjëse për zbatimin ose jo, për përgjegjshmërinë apo jo të, për ndershmërinë apo jo të institucioneve që auditohen. Pra, na lind ne si detyrë dhe institucioneve që kanë në varësi institucionet e kontrolluara të shohim nëse janë zbatuar, apo jo. Patjetër, KLSH-ja duhet ta bëjë pjesën e saj, siç ka rezultuar nga raporti.

Një gjë tjetër, që doja ta përmendja dhe që më duket dhe pjesa më pozitive, ose një nga elementet më pozitive në institucionet e pavarura, është fryma që KLSH-ja krijon në të gjitha institucionet që auditon. Nuk po themi se është frymë frike, por rregullshmërie. Pra, shpeshherë institucionet ndihen të detyruara të ecin drejt, vetëm duke marrë në konsideratë pjesën që kanë një institucion, i cili i auditon dhe i kontrollon. Pra, edhe këtë pjesë unë do ta vlerësoja, patjetër që do të mbështesja pjesën e zonjës Denaj për bashkërendimin dhe frymën e bashkëpunimit.

Nuk kam ndonjë koment tjetër, thjesht doja t'i falënderoja për praninë dhe të gjithë seriozitetin në dhënien e përgjigjeve.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Resulaj.

Pranvera Resulaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, edhe unë kam një koment shumë të shkurtër, për të cilin u ngacmova nga komenti i kryetarit, i cili tha se duhet të synojmë më shumë te parandalimi i shkeljeve se sa penalizmi, duke e argumentuar me arsyet sociale dhe psikologjike për të gjithë shoqërinë, që mund të kenë procedurat e vazhduara pas shkeljeve në procedimet penale dhe më tej. Unë e lexova si një vizion, e përgëzoj për këtë, pasi është një vizion shumë i guximshëm, në një kohë që Kontrolli i Lartë i Shtetit është një institucion që përcjell një hije të rëndë tek të gjitha institucionet. Jam shumë e sigurt që, nëse kjo teori dhe ky vizion shtjellohen me tej, duke ndërtuar një strategji efikase dhe të mirëfilltë, do të jetë më rezultativ se ajo që mund të kemi arritur deri tani. Në vijim të kësaj, kjo strategji mund të ndërtohet edhe duke iu referuar asaj që thanë më parë kolegët dhe paracaktuan se si mund të ndërtohet mbi bazën e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të krijuara me institucionet që janë objekt auditimi. Sigurisht, ka shumë mënyra për ta arritur këtë, por unë ju përgëzoj dhe do të doja t'ju nxis të ndërtoni një strategji për këtë vizion shumë të qartë që përcollët te ne.

Sigurisht, probleme ka, ne nuk mund të pretendojmë që gjithçka funksionon në më të mirën e mundshme, por jam shumë e sigurt që do të kemi rezultate më të mira nëse ju e vazhdoni këtë vizion që keni.

Ju faleminderit!

Punë të mbarë!

Eduard Shalsi – Zoti Agalliu, pastaj zonja Gjylameti.

Arbi Agalliu – Faleminderit!

Ai 6-përqindëshi i mosrealizimit të rekomandimeve në optikën time është pothuajse jodomethënës. Me gjithë atë punë voluminoze 6% do të thotë që mund të jenë edhe keqkuptime, mund të kërkojnë kohën e duhur, mund të ketë keqinterpretime. Problemi qëndron që, nëse këto rekomandime të paplotësuara rievidentohen nga KLSH-ja mbi një analizë të thellë dhe përsëri nuk gjejnë zbatueshmëri, atëherë duhet parë, por prapë 6% në optikën time është një shifër e papërfillshme në të gjithë atë volum pune.

Doja të bëja një pyetje në raport me kërkesat apo ankesat eqytetarëve të ndryshëm që ju vijnë në KLSH. Çfarë strategjie ka? A zbatohet afati i kthimit të përgjigjeve ndaj qytetarëve, të cilët e shohin KLSH-në si një mundësi të zgjidhjes së halleve të tyre, apo të shfrytjes së atij inati për moszgjidhjen e problemit që kanë institucionet të ndryshme të administratës publike?

Faleminderit!

Arben Shehu – A mund të përgjigjem?

Eduard Shalsi – Po, patjetër.

Arben Shehu – Në lidhje me pyetjen për ankesat, është një pyetje shumë e rëndësishme, pasi lidhet me një ndjeshmëri shumë të madhe të marrëdhënieve tona me qytetarët, dua të shpjegoj se në vazhdimësi kemi një numër të lartë të kërkesave dhe ankesave, por edhe të denoncimeve të rasteve të ndryshme. Për këto raste bëhet një analizë, mund të them që në 100% të rasteve kemi analizë të parashtrimeve të qytetarëve të drejtuara institucionit, por përgjigjja jepet në varësi të veprimeve dhe kohës së nevojshme për të kryer këto veprime. Në përfundim të tyre patjetër që zbatohet detyrimi për të kthyer përgjigje, të argumentuar me shkrim, për të gjitha veprimet që janë kryer, edhe për rezultatet që kanë dalë nga këto veprime. Pra, përgjigjja jepet mbi bazën e konkluzioneve dhe konstatimeve që dalin nga veprimtaria.

Në shumë raste këto ankesa trajtohen në auditimet që janë në programin vjetor dhe për raste të veçanta, kur vlerësohet se janë të rëndësishme apo prekin një numër lartë, ose ka një risk të lartë për shoqërinë, këto denoncime apo ankesa trajtohen në auditime të veçanta tematike. Pra, këtu kemi të bëjmë me një lloj shtese të numrit të auditimeve.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Duke ju falënderuar për pjesën e përgjigjeve, unë më shumë kam një qëndrim se sa pyetje apo sqarime të tjera.

Lexova me shumë vëmendje si pyetjet që kam drejtuar, ashtu edhe pyetjet që drejtuan kolegët, si dhe përgjigjet tuaja, që për pjesën më të madhe ishin shteruese. Vazhdoj të kem atë qëndrim që kisha në krye të herës, që roli i Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe juaji, si drejtues, duhet të jetë më proaktiv, duhet të ketë disa ndryshime rrënjësore në mënyrën si funksionon Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe, mbi të gjitha, në funksionin dhe qëllimin që ka.

Së pari, besoj se është shumë e rëndësishme ngritja e një *database* dhe çdo qëndrim dhe çdo vendimmarrje duhet të jetë e bazuar në një *database*. Nëse ne nuk kemi një *database* të pjesës së observimeve, që u janë bërë raporteve që pas auditimeve në institucione të caktuara dhe ndryshimeve të raporteve pas vëzhgimeve, nuk do të mundemi të kemi një përmirësim të pjesës së metodologjisë dhe të punës suaj. Si në çdo institucion tjetër, ashtu edhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit besoj se është thelbësore të kemi një *database* dhe jo vetëm për të pasur transparencë më të madhe përkundrejt publikut dhe fondeve publike, por, mbi të gjitha, që t'ju shërbejë si mekanizëm për të përmirësuar punën tuaj dhe për të reflektuar se çfarë duhet ndryshuar.

Pse e nisa nga *database*, sepse edhe një pjesë e pyetjeve lidhen me *database*-n , po ashtu edhe përgjigjet, por edhe pjesa e raporteve pas auditit dhe raporteve përfundimtare pas vëzhgimeve. Në momentin që ne nuk kemi një *database*, përsëri këtu do të vijojë dyshimi se ndryshohen për shkak të efekteve të tjera dhe jo për shkak të asaj që ju keni sqaruar, duke u bazuar në ligjin përkatës dhe në të gjitha ligjet, ku bazohet puna juaj, apo dhe rregulloret e brendshme. Duke pasur një *database* çdo gjë funksionon për të ndryshuar metodologjitë e auditimit. Ju na keni kthyer një përgjigje në lidhje me grupet e punës që janë ngritur për ndryshimet e metodologjive të auditimit, duke u bazuar në rregullat apo standardet e INTOSAI-t. Patjetër që po, por të gjitha këto, nëse nuk do të kemi *batabase*, përsëri do të jenë subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme, sepse nuk janë të bazuar në të dhëna përkatëse.

Ndërkohë edhe në pjesën e publikimeve më keni dhënë një përgjigje, ku kryesisht sqarohet se ku bazohet puna juaj, në cilat ligje dhe cili është kuadri rregullator që normon detyrat, funksionet e secilit, që nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, drejtorët deri te procedurat që ndiqen.

Përpos kësaj që kemi, prandaj e nisa në krye të herës me rolin proaktiv, KLSH-ja duhet të ketë një rol tjetër, një rol më të fokusuar në eficiencën e shpenzimeve të parasë publike. Sikundër e thashë në krye të herës, jo vetëm në konstatime, jo vetëm në kallëzime, jo vetëm në atë që ndodh sot, por edhe në atë çfarë duhet të jetë. Ju e thatë në fjalën tuaj sot, unë e dëgjova më shumë vëmendje, rolin parandalues shumë më tepër se rolin penalizues, apo masat që merren pas ndodhjes, ne do të duhet të ndryshojmë mënyrën se si funksionojnë apo se si ju sugjeroni, falë konstatimeve që bëni të punës suaj gjatë auditimeve, ndryshimet që duhet të ketë edhe në ligjin për prokurimin publik, madje edhe mënyrën si funksionojnë agjencitë, edhe se si ne duhet të ndërmarrim nisma ligjore për të përmirësuar procedurat aktuale, që të mos diskutojmë sa është dëmi, por se si ka ndryshuar mënyra e prokurimit publik, si ka ndryshuar dhe si rritur eficientia e shpenzimeve të parave publike. Në këtë mënyrë ajo që ndodh më pas do të jetë qoftë dëm më i ulët, qoftë dhe vënia para drejtësisë së atyre personave që shkaktojnë dëm.

Në anën tjetër, çdo gjë do të lidhet me atë që thashë në krye të herës, janë disa elemente lidhen qoftë me konstatimet tuaja gjatë punës apo auditimet, qoftë me prioritetet. Zoti kryetar i Kontrollit të Lartë të Shteti, besoj se në çdo institucion ne kemi nevojë, dhe kur them për ju, flas dhe për çdo institucion tjetër, të ketë një prioritet të punës. Sot ne diskutojmë që kemi mungesë të kapaciteteve, ndaj nuk arrijmë të bëjmë siç duhet çdo element të punës sonë apo t'i ndjekim procedurat siç duhet, apo të arrimë që në të njëjtën kohë të kemi të gjitha auditimet dhe kontrollet

që duhen. Duhet të ketë prioritete, duhet të hartojmë një listë prioritetesh, ju duhet ta keni në pikën e parë të planit tuaj të punës se cilat janë prioritetet, si duhet të mirëmenaxhohen burimet njerëzore që kemi në dispozicion, si duhet të mirëmenaxhojmë dhe të rrisim kapacitetin e burimeve njerëzore, por kjo bëhet në bazë të një prioriteti.

Jam e bindur që do ta kemi këtë gjë në vijim, duke pasur një bashkëpunim shumë më të mirë, duke nisur edhe organizimin e ri që është bërë në Kuvendin e Shqipërisë, po ashtu edhe në rolin që kemi marrë ne, si Komision i Ekonomisë, për të koordinuar punën ndërmjet jush dhe institucioneve të tjera, për të arritur që, falë bashkëpunimit që do të keni ju me institucionet dhe koordinimin nga parlamenti i Shqipërisë, t'i ndryshojmë të gjitha, që në rezolutën e ardhshme të diskutojmë si është rritur efienca e parasë publike shumë më tepër së sa janë dëmet dhe konstatimi i dëmeve.

Ju faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Po, keni një koment të fundit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirë, bëjeni shpejt dhe ta përmbyllë kryetari i KLSH-së.

Antoneta Dhima – Ndjesë kryetar, por në lidhje me proceset gjyqësore, ju keni saktësuar që janë 28 procese gjyqësore penale, nga të cilat 12 janë pushuar. A keni bërë ju, si institucion, një analizë në lidhje me pushimin e këtyre çështjeve, cilat kanë qenë arsyet dhe personat, të cilët kanë qenë përgjegjës për hartimin e dosjes, për përgatitjen e dokumentacionit dhe dërgimin e tij pranë gjykatës. A ka një analizë nga institucioni juaj në lidhje me personat përgjegjës?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, duke përmbyllur fjalën tuaj, jepni një përgjigje për zonjën Dhima, edhe një koment për sa tha zonja Gjylameti, por edhe kolegët e tjerë.

Arben Shehu – Në lidhje me qëndrimin e zonjës deputete, zonjës Gjylameti, zonja deputete e parashtrori në një nevojën që institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit të jetë më proaktiv dhe në të njëjtën kohë të ketë një *database*. Unë mendoj se këto janë 2 situata të ndryshme. Të qenit proaktiv, unë e vlerësoj shumë, madje e kemi në fokusin tonë, është prioritet i punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe mendoj se e kemi realizuar dhe do ta mbajmë në vëmendje maksimale.

Në lidhje me *database*-n, dua të theksoj edhe një herë atë që parashtrova, të gjitha institucionet nuk duhet të ngelen në nivelin e vizionit për të pasur *database* apo për të mbledhur të dhëna, pasoja, dëme të shkaktuara nga situata të ndryshme, nga individë të ndryshëm apo nga grup individësh, por duhet të jenë proaktivë, duke u nisur nga ju, për të ndërtuar, në radhë të parë, pastaj për të rritur punën parandaluese, në mënyrë që të parandalohet dëmi i shkaktuar buxhetit të shtetit, por në të njëjtën kohë dëmi që i shkaktohet shoqërisë shqiptare, familjeve shqiptare nga rastet për të cilat ju, me shumë të drejtë dhe me shumë kujdes parashtruat në rastet e nevojave për ndjekje penale. Edhe një herë dua të theksoj se në këto raste duhet të jemi proaktivë, në mënyrë që të parandalojmë, sepse është më i rëndësishëm parandalimi i dëmtimit të buxhetit të shtetit, njëkohësisht edhe parandalimi i dëmtimit të të gjithë sistemit shoqëror shqiptar nëpërmjet këtyre procedimeve penale.

Kuptohet që në rastet e konstatimeve të veprave penale do të kryejmë ato detyrime që kemi për atë kallëzim penal. Njëkohësisht edhe prokuroria do të kryejë po ato detyrime, të cilat Kushtetuta dhe ligji organik i ngarkon për të kryer, por mendoj se të gjithë ne, edhe Kontrolli i Lartë të Shtetit, edhe prokuroria janë qytetarë të këtij shteti dhe ndiejnë nevojën e parandalimit, pra të minimizimit të dëmeve qoftë financiare, qoftë shoqërore. Unë mendoj se edhe ju, ose më saktë roli proaktiv duhet të fillojë nga ju, zonja Gjylameti dhe kolegët e tjerë, dhe ne do të jemi të gatshëm në çdo moment që ju të ndërtoni strategji të kryejmë të gjitha veprimet maksimale të duhura për t'i kryer këto detyra.

Faleminderit!

Për pyetjen e koleges në lidhje me ato raste kur nga prokuroria vendoset mosfillimi apo pushimi, ne kemi qenë të detyruar të kryejmë me akt ankimi për vendimin, kuptohet mbi bazën e një analize të dytë të kryer në institucion për rastin dhe në përfundim kemi qenë të detyruar, të bindur në 100% të rasteve, se jemi përpara një fakti penal dhe kemi insistuar me akt ankimi kundër këtyre vendimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk mund ta them këtë. Ne po kryejmë ato detyrime që duhet të kryejmë dhe besoj se do të ketë rezultat në vazhdimësi.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, duke falënderuar kolegët deputetë për pyetjet, kryetarin dhe stafin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për përgjigjet, do të doja të thosha edhe unë 2 fjalë për përmbyllje.

Po, është e vërtetë që parlamenti dhe ky komision ka hapur një udhë të re në raportet me institucionet e pavarura dhe ne kemi pasur këto javë në parlament disa institucione të pavarura, të cilat kanë raportuar dhe me të cilat po përcaktojmë, në bazë të rezolutave që Kuvendi do të miratojë, planin e punës për vitin e ardhshëm. Një gjë kemi rakorduar, që të mos mbetemi në takimet vjetore, por të kemi takime ndoshta të përmuajshme, 1 herë në 3 muaj, për t'u azhornuar dhe për të ushtruar funksionet tona si parlamentarë. Nga sa kemi monitoruar në institucionet shqiptare, jo vetëm ato që vijnë e raportojnë në parlament, por edhe gjatë vizitave që kemi konstatuar në agjenci, apo institucione të ndryshme shtetërore, kemi konsistuar disa fakte të cilat besoj se, dhe këtu do të ftoj të gjithë kolegët, teksa do të hartojmë rezolutën për KLSH-në, siç po bëjmë me Bankën e Shqipërisë, siç po bëjmë me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, të marrin pjesë dhe të sugjerojnë, nisur edhe nga përgjigjet, nga pyetjet apo edhe roli proaktiv që po deklarohet nga të gjitha palët dhe ku po konvergojmë të gjithë.

Po jetojmë në kohën e një revolucioni digjital dhe fatkeqësisht në vëmendjen tonë konstatojmë që, ndërsa është për t'u përshëndetur shumë fillimi i shërbimeve *online*, me gjithë vështirësitë e fillimit, ka shumë institucione të papërgatitura për sisteme menaxhimi informacioni të brendshme. Një nga prioritetet e punës sonë për institucionet, por do ta diskutojmë bashkërisht edhe për pjesën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, është ngritja e nivelit të auditimit edhe për shkallën e aplikimit të teknologjisë së informacionit, që aplikojnë institucione të ndryshme. Për mua, është krejtësisht e papranueshme që, për shembull, institucionet të mos kenë një protokoll të digjitalizuar. Unë nuk arrij ta kuptoj si një titullar institucioni i një agjencie të rëndësishme të mos marrë një hartë të letrave, që kanë hyrë në institucion me bazë ditore, për të kuptuar për çfarë shkruajnë subjektet, qytetarët, apo bizneset, për çfarë ankohen, çfarë shërbimesh duan të përmirësojnë. Ndaj, një nga pikat ku ne do të përqendrojmë vëmendjen tonë do të jetë edhe aplikimi i teknologjisë së informacionit, që po revolucionarizon, për hir të së vërtetës, dhe po modernizon shumë institucione. Mënyra, si një institucion trajton një aplikim, një leje apo një autorizim në procesin e shqyrtimit, tregon shumë për domethënien e punës së atij institucioni, pra çfarë ndodh dhe çfarë sistemi të brendshëm informacioni përdorin institucionet për të trajtuar kërkesat e qytetarëve apo të biznesit. Roli ynë është mirëqenia e qytetarëve, ruajtja e

konsumatorëve. Si mund ta bëjmë këtë dhe si mund ta bëjnë këto institucione, në të cilat vështirësisht mund të gjejmë një gjurmueshmëri normale të letrës, kërkesës që vjen nga qytetari, apo nga biznesi? Kemi institucione, madje, të cilat mbështesin financiarisht biznesmenë dhe aplikimet vazhdojnë dhe bëhen me letra. Pra, një nga pikat ku ne duam të përqendrohet puna jonë në lidhje me agjencitë e tjera, por edhe kërkesë për Kontrollin e Lartë të Shtetit do të jetë fuqizimi i komponentit të kontrollit të sistemeve, që menaxhojnë këto institucione.

Së dyti, janë burimet njerëzore, ju jeni në dijeni të vendimeve të qeverisë apo të institucionit që monitoron rekrutimin e punonjësve. Është shumë e rëndësishme, teksa një institucion monitorohet, se çfarë *background*-i kanë personat, si janë rekrutuar, si janë marrë në punë dhe këtu nuk përjashtoj edhe rolin, që është minimizuar me kalimin e kohës, i plotfuqishëm dikur, e deputetëve, që emëronin njerëz. Na është dashur të shkojmë në 2-3 institucione për vizitë dhe të kuptojmë brenda një kohe shumë të shkurtër, pa bërë punën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, thjesht duke parë mjediset e punës, thjesht duke parë logjistikën, thjesht duke parë rrëmujën institucionale, thjesht duke parë mënyrën si rekrutoheshin njerëzit, se çfarë mund të prisje prej atyre institucioneve. Në këtë kontekst, duam institucione të forta, duam që realisht të ndiejnë peshën e përgjegjësisë, që institucionet kanë në lidhje me mirëmenaxhimin dhe miradministrimin e parasë publike, por nuk mund të jenë të tilla nëse kriteret e emërimit, sistemet që përdorin, procedurat që ndjekin, nuk do të jenë në nivelin e kërkuar nga qytetarët.

Ndaj kjo është një dëgjese, ndërkohë që me Bankën e Shqipërisë, me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, me INSTAT-in, një rol shumë të rëndësishëm ka INSTAT-i, ne jemi vendimmarrës dhe ndonëse hera-herës na qëllon që, përpos synimit të mirë të vendimmarrjes, për shkak të të dhënave të pasakta, vendimmarrja është e pasaktë. Po bashkëpunojmë tani edhe me INSTAT-in, që furnizon vazhdimisht me raporte, me të dhëna, të cilat janë indikatorë, tregues për ekonominë, si po shkon papunësia apo të dhëna të tjera të domosdoshme për ne, po kështu me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, që ka një treg shumë të rëndësishëm, dhe institucione, të cilat, nëse nuk harmonizojnë punën me institucionet e tjera, do të jetë e pamundur t'u shërbejnë klientëve. Autoriteti i Konkurrencës po ndryshon qasje. Diskutoni mënyrën klasike të Autoritetit të Konkurrencës, për t'ju dhënë një shembull, se aty pashë edhe një dokument të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por do të doja ta diskutoni në muajt në vijim. Nuk është objektiv konkurrenca i Autoritetit të Konkurrencës dhe kur u tha kjo shprehje, në fakt, shkaktoi edhe ilaritet, pra nuk është objektiv i Autoritetit të Konkurrencës konkurrenca. Po cili është? Është eficensa e tregut, procesi

quhej konkurrencë, çka ndryshonte gjithë qasjen, por u desh të vinin 1,2,3 specialistë të huaj për këtë.

Për të dalë tani te pika tjetër, sigurisht penalizimi është një mjet i domosdoshëm, por ajo që duhet të synojmë është edhe trajnimi dhe, në këtë kontekst, roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me ekspertizën, me eksperiencën që ka, duhet të synojë edhe një fushatë, dikush e tha, sensibilizimi, unë do të thosha edhe trajnimesh, edhe bashkëbisedimesh, edhe kontaktesh me institucionet, përtej kontakteve shkresore dhe burokratike. Ka dhe një formë që po e praktikojmë, po shohim, kemi ndërmjetësuar midis 2-3 institucioneve dhe po ju them se ajo që nuk ishte bërë për 3 muaj, një agjenci e bëri për 3 muaj, për të aplikuar një sistem i cili gjurmon të gjitha kërkesat e qytetarëve, që nga dita që arrijnë atje. Na duhej të pyesnim, të prisnim me ditë, apo dhe me javë, për të kuptuar sesi trajtohej një aplikim, një kërkesë te një institucion, ndërkohë që u ulën 3 institucione, një ministri, një agjenci dhe AKSHI dhe bënë atë që nuk ishte bërë prej muajsh. Sot me 1, 2, 3 klikime arrin të kuptosh ku gjendet kërkesa e x subjekti, qoftë person fizik ose jo.

Gjithsesi, ky është takimi vjetor, që ne nuk do të donim të mbetej një herë në vit, duke u nisur edhe nga sasia e madhe e pyetjeve. U kuptua që një pjesë e mirë e atyre pyetjeve mund të ezaurohen edhe gjatë kontaktit vjetor.

Kishit diçka për të shtuar? Po, kryetar, fjala është për ju.

Arben Shehu – Në emër të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dua të falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për mundësinë që na dhanë, për kohën e mjaftueshme për të parashtruar të gjithë punën tonë vjetore, pra raportimin e plotë, pavarësisht se pjesërisht, deri diku, nuk u vlerësua ai 94%-shi, por u kritikua pjesa e mbetur e 6%-shit të moszbatimit të rekomandimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po çfarë mund të themi ne, kur, si pjesë e 6%-shit, kemi pasur raste të rekomandimit të shkarkimit të punonjësve, apo për më të tepër të ndonjë drejtuesi institucioni dhe në auditimin e radhës në institucionin tjetër ne e kemi gjetur në të njëjtën pozitë, apo në një pozitë më të lartë. Kjo nuk është përgjegjësia jonë. Megjithatë, ne jemi të bindur te bashkëpunimi me institucionet, me të gjitha subjektet në auditim dhe mendoj që është e rëndësishme për t'u parë pjesa e përgjithshme pozitive nga të gjithë.

Ju falënderoj të gjithëve për mundësinë dhe për vëmendjen!

Eduard Shalsi – Stafet përkatëse do të mbeten në kontakt për rezolutën, do të ketë një draft. Zonja Dhima, tani jemi në fazën e propozimeve për rezolutën. Kështu që, sipas traditës, stafet do të bashkëpunojnë dhe pastaj ne do të marrim një vendim. Ndërkohë është përcaktuar data e raportimit në Kuvend?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, duke ju falënderuar, e mbylлим mbledhjen e sotme për t'u takuar javën e ardhshme.

Faleminderit për të gjitha shpjegimet!

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretare e Komisionit
Redaktorëve
Enslemvera Zake**

Përgjegjësja e Sektorit të

Euzheni Pengili

**Sekretar administrativ
Elvi Prifti**